

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 18-24.11.2024

Janë testuar gjithsej 135 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=194) është shënuar një rënie prej 30,4%.

Pozitive janë 4 raste, 2 më shumë nga java e kaluar. Përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 7,7%, mesatarisht 2,4%.

***Tabela 1.** Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 18-24.11.2024*

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
18.11.2024	35	2	5,7%
19.11.2024	28	1	3,6%
20.11.2024	13	1	7,7%
21.11.2024	22	0	0,0%
22.11.2024	18	0	0,0%
23.11.2024	10	0	0,0%
24.11.2024	9	0	0,0%
Gjithsej	135	4	mesatarja 2,4%

Gjatë javës së kaluar raste janë regjistruar në Shkup (n=3) dhe Ohër (n=1).

Raste të reja janë regjistruar tek grupmosha mbi 30 vjet.

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 5 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (18-24.11.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2024, deri më 24.11.2024, janë regjistruar gjithsej 1.743 raste me COVID-19. Në muajin tetor të vitit 2024 (56) regjistrohet një rënie prej 80,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 24.11.2024, janë testuar gjithsej 12.721 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 25.11.2024

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>